

*Aleksandër A. Novik, Julia V. Buçatskaja,
Aleksandra S. Dugushina, Denis S. Ermolin,
Maria S. Morozova*

**“EKSPEDITA NË DETIN AZOV”.
GJUHA DHE KULTURA
E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS**

Përmbledhje

**Pjesa I
Vëllimi 1**

***Aleksandër A. Novik. Parathënie. Shqiptarët e Ukrainës,
“Ekspedita në Detin Azov”, malet e Ballkanit dhe fushat e Detit të Zi:
mitet dhe stereotipet***

Në parathënien e monografisë kolektive sqarohet historia e projektit shkencor në terren “Ekspedita në Detin Azov” (1948–2016), me fokus kryesor në studimet e kulturës tradicionale dhe të gjuhës së shqiptarëve të Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov. Themeluese dhe organizatore e këtij projekti ka qenë Julia Vladimirovna Ivanova (1929–2006). Për herë të parë ajo ka bërë studime në terren tek shqiptarët e rajonit të Detit Azov në vitin 1948. Më vonë puna e saj shkencore u vazhdua nga plejada e studiuesve të rinj, që janë autorë të këtij libri. Në parathënie formulohen qëllimet dhe detyrat shkencore që ishin kryesore për grupin e autorëve, përvijohet gjendja aktuale e studimeve dhe përshkruhet gjendja e sotme si në perëndim të Gadishullit Ballkanik (ku jeton shumica e etnosit shqiptar) ashtu edhe në fshatrat shqipfolëse të Ukrainës. Kështu, qëllimi kryesor i kësaj monografie është analiza e plotë e ruajtjes së kulturës tradicionale dhe përshkrimi i gjuhës së grupit etnolokal të shqiptarëve që nga koha e mërgimit në Perandorinë Ruse deri në ditët e sotme. Aktualitetin e projektit autorët e shohin posaçërisht në studimin e diasporës shqiptare në rrethanat e bashkëjetesës shumëshekullore ndër etni të ndryshme, në shtjellimin e kushteve të ruajtjes së tipareve unike në

periudhën moderne, d.m.th. në kushtet e kontakteve aktive gjuhësore dhe kulturore në rajonet polietnike, të cilat karakterizohen nga niveli i lartë i fshirjes së traditës dhe formimi i të ashtuquajturave dukuri dhe realitete mbietnike.

Kreu I. SHQIPTARËT E UKRAINËS: HISTORIA E GRUPIT ETNIK DHE E STUDIMIT TË TIJ

***Aleksandër A. Novik.* Shqiptarët e Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov: fakte dhe shifra**

Ky punim përmban të dhënat kryesore mbi numrin e shqiptarëve të Ukrainës, vendbanimet e tyre në territorin midis lumenjve Prut dhe Dnjestër dhe në Detin Azov (rajonet e Odesës dhe Zaporizhjes në ditët tona), etapat kryesore të historisë së kolonizimit të këtyre territoreve nga ballkanasit. Autori, kryesisht në bazë të materialeve arkivore dhe të mbledhura në terren, të dhënave të studiuesve të shekujve XIX–XX, si dhe studimeve të mëparshme për të njëjtën temë, bën përpjekje për ripërvijimin e vendbanimeve të mëparshme të paraardhësve të shqiptarëve të Ukrainës në territorin e Shqipërisë Juglindore të sotme, përshkruan rrugëtimet e mërgimit të tyre në verilindje të Bullgarisë, analizon shkaqet e ikjes së tyre më parë nga perëndimi në lindje të Gadishullit Ballkanik dhe më vonë, në fillim të shekullit XIX në Perandorinë Ruse. Në këtë punim jepet statistika mbi numrin e shqiptarëve, të cilën e kemi në dispozicion që nga shekulli XIX, si dhe të dhënat e mbledhura gjatë studimeve në terren në bazë të dokumenteve arkivore të komunave (fshatrave) dhe burimeve të tjera. Autori analizon dukurinë e ruajtjes së grupit etnolokal të shqiptarëve në kushtet e bashkëjetesës me etni të ndryshme në territore shumë larg trojeve shqiptare gjatë një periudhe afro pesëshekullore. Në studim janë përfshirë shumë rrëfime dhe dokumente arkivore që ilustrojnë stereotipet dhe parimet në vlerësimin e historisë së vet, traditave, gjuhës dhe kulturës (këndvështrime dhe dukuri të cilat janë gjithmonë në gjendje kalimtare).

***Denis S. Ermolin, Maria S. Morozova.* Studim etnografik dhe gjuhësor për shqiptarët e Ukrainës**

Në kapitullin e D.S. Ermolinit dhe të M.S. Morozovës jepet një pasqyrë e shkurtër e historisë më se njëqindvjeçare të studimit të gjuhës dhe kulturës së shqiptarëve të Ukrainës, nga punimet pioniere të akademikut Nikollaj S. Derzhavin, i cili i ka takuar shqiptarët për herë të parë në vitin 1910, gjatë udhëtimit të tij në Buxhak, dhe deri në fazën më të re të kërkimeve etnografike dhe gjuhësore të kryera në bazë të materialeve të ekspeditave komplekse nëpër fshatrat shqiptare të Ukrainës, zhvilluar me pjesëmarrjen e autorëve të kësaj monografie kolektive. Në mënyrë kronologjike në kapitull bëhen përpjekje për paraqitjen e plotë të

etapave kryesore, si dhe përmenden emrat e studiuesve të cilët u morën me studimin e këtij grupi etnolokal në periudhat sovjetike dhe postsovjetike, përfshirë këtu kontributin e J.V. Ivanovës, N.V. Kotovës, O.S. Shirokovit dhe të L.J. Demkos, ekspeditat dhe botimet e përfaqësuesve të shkollës së albanologjisë të Leninogradit / Sankt-Petërburgut (A.V. Desnickaja, G.I. Ejntrej, I.I. Voronina, A.P. Sitov, L.V. Sharapova, A.V. Zhugra, M.V. Domosileckaja, A.J. Rusakov etj.). Në fazën e tanishme, bashkë me ekspeditat e rregullta në fshatrat shqiptare dhe me botimin e një numri të konsiderueshëm punimesh kushtuar kulturës tradicionale, çështjeve të identitetit dhe ruajtjes së gjuhës, rëndësi të madhe marrin projektet e bashkëpunimit ndërkombëtar midis shkencëtarëve rusë dhe të huaj, veprimtaritë muzeale dhe arkivore të punonjësve të MAE-së, si dhe studimi i gjuhës dhe kulturës në nivel lokal (veprimtaria e specialistëve të rajonit dhe e mësuesve të shkollave). Bibliografia e kapitullit (shih gjithashtu “Listën e botimeve të autorëve të monografisë kolektive kushtuar shqiptarëve të Ukrainës”) pasqyron në mënyrë relativisht të plotë arritjet e shkencëtarëve vendas e të huaj në fushën e studimeve etnografike dhe gjuhësore të shqiptarëve të Ukrainës.

Aleksandër A. Novik, Julia V. Buçatskaja. Si ka ndodhur: historia, metodika, jetesa dhe të fshehtat e studimeve shkencore në terren në rajonin e Detit Azov dhe në Buxhak

Në kapitull analizohet në mënyrë përsiatëse përvoja e studimeve shkencore në terren në kuadër të projektit “Ekspedita në Detin Azov” nëpër vite. Pjesa e monografisë përbëhet nga dy paragrafë në formë polemike midis dy këndvështrimeve, të udhëheqësit dhe atë të pjesëmarrësit të ekspeditës. Vëmendja i kushtohet jo vetëm zhanrit të përhapur kohët e fundit në etnologji për sqarimin e metodikës së punës shkencore në terren dhe organizimit të ekspeditave, por edhe temave relativisht të reja në botimet etnografike në Rusi, për shembull anët subjektive të studimeve në terren (marrëdhëniet në grup, raportet me informantët). Autorët shprehin mendime kritike në lidhje me rendimentin ~ jorendimentin e metodikave të përdorura, mundësitë e humbura, pritshmëritë që nuk u realizuan. Shpjegohen me detaje veçoritë e jetës së përditshme dhe të komunikimit brenda ekspeditës, duke evidentuar anë materiale, por edhe fiziologjike të procesit shkencor, që zakonisht nuk përmenden nëpër botime dhe sytë e lexuesit nuk mund t'i rrokin.

Maria S. Morozova, Aleksandër A. Novik. Një histori e shkurtër e formimit të fshatrave shqiptare të Ukrainës: fakte dhe mite

Në pjesën e parë të kapitullit, shkruar nga M.S. Morozova dhe A.A. Novik, përshkruhet historia e mërgimit të paraardhësve të shqiptarëve të sotëm të Ukrainës nga juglindja e Shqipërisë moderne në verilindje të Bullgarisë, dhe

mandej në Perandorinë Ruse, në stepat e Buxhakut e më pas të Azovit. Autorët kanë për qëllim përmbledhjen dhe paraqitjen e rregullt të materialeve të disponueshme, të nxjerra nga dokumentet e shekullit XIX (studimet statistikore e P. Köppen-it, A. Klaus-it, A.A. Skalkovskit etj.), veprat e hershme për shpërnguljen e arnautëve (K. Jireček, L. Miletiq, V. Marinov, D. Jaranov), nga arkivat dhe artikujt shkencorë të akademikut N.S. Derzhavin, si dhe botimet e albanologëve të Leninogradit / Sankt-Petërburgut (A.V. Desnickaja, L.V. Sharapova, A.V. Zhugra) dhe të etnologëve bashkëkohorë ukrainas që merren me studimin e Buxhakut (A.V. Shabashov). Pjesa e dytë e këtij kapitulli i kushtohet çështjes së rëndësishme të mitologjisë historike të shqiptarëve të Ukrainës, d.m.th. legjendave, gojëdhënave dhe kujtimeve të lidhura me historinë e këtij grupi etnolokal, që ruhen dhe përcillen deri tani gojë me gojë. Këtu pasqyrohen përfytyrimet dhe mendimet e banorëve të sotëm të fshatrave shqiptare për mëmëdheun e tyre historik, për shpërnguljen e stërgjyshërve të tyre nga Ballkani në Perandorinë Ruse, për themelimin e fshatit Karakurt, për mërgimin e një pjese të popullsisë nga Buxhaku në bregdetin Azov dhe për formimin e tri vendbanimeve të reja. Të dhënat e paraqitura dhe të analizuar janë marrë nga të anketuarit në fshatrat Karakurt, Georgievka, Devninskoje dhe Gammovka gjatë ekspeditave të viteve 1998–2013.

Aleksandër A. Novik, Julia V. Buçatskaja. Identiteti i shqiptarëve të rajonit të Detit Azov: endoetnonimi, vetëdija dhe komponentët e kujtesës historike kolektive në kontekstin historik, gjuhësor dhe jashtgjuhësor

Në kapitull sqarohen çështjet lidhur me mënyrën se si kolonët shqiptarë e kuptojnë vendin e tyre, sidomos në rajonet polietnikisht të ndërlikuara të rajonit të Detit Azov dhe të Buxhakut. Analizohet aspekti historik i fqinjësisë së grupeve mërguese nga Gadishulli Ballkanik në territorin e Perandorisë Ruse me njëri-tjetrin edhe me rusët dhe ukrainasit në kohën e mëvonshme sovjetike dhe në periudhën e Ukrainës së pavarur, shpjegohet shfaqja dhe zhvillimi i klisheve kulturore dhe i stereotipeve reciproke, dinamika e parapëlqimeve martesore dhe e gjuhës së komunikimit në kuadrin e mjedisit agrar që studiohet. Autorët sqarojnë me hollësi problemin e vetidentifikimit të shqiptarëve të rajonit të Detit Azov, që shprehet leksikalisht si dukuri me mungesën e endoetnonimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë gjuhës si kriter kryesor anëtarësie tek grupi i tyre. Të dhënat gjuhësore, veç të tjerash, i kanë ndihmuar autorët që të plotësojnë hipotezat e mëparshme që ekzistojnë lidhur me vendin e prejardhjes së shqiptarëve të Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov dhe ta lokalizojnë zanafillën e tij në krahinën e Devollit në juglindje të Shqipërisë së sotme. Po aq të rëndësishme janë ato aspekte identiteti të grupit në studim, që shfaqen si lidhje konfesionale dhe lokale. Feja e krishterë ortodokse ka qenë një nga faktorët e mërgimit të kolonëve ballkanas në shekullin XIX në territorin e Perandorisë Ruse ortodokse. Reliket

e krishtera të trashëguara nga paraardhësit e fshatrave shqiptare Georgievka, Devninskoe dhe Gammovka, së bashku me gjuhën, kanë evoluuar në një sistem simbolesh identitare, i cili përmban një sugjerim të ngushtë lokal dhe përcaktohet nga lidhja me fshatin amtar dhe banorët e tij të parë.

Kreu II. TRADITAT DHE PRAKTIKAT NË KULTURËN E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS

Ritet familjare

Aleksandra S. Dugushina. Ritet e lindjes ndër shqiptarët e Ukrainës

Kapitulli merr në shqyrtim besimet dhe praktikat popullore që lidhen me lindjen e fëmijës në traditën e shqiptarëve të Ukrainës. Materialet për ritet e lindjes janë grumbulluar prej autores gjatë kërkimit në terren, kryer në gjashtë ekspedita nëpër fshatrat shqiptare të rajonit të Detit Azov (Georgievka, Gammovka, Devninskoje, 2007–2011) dhe në Karakurt (2013). Ato materiale pasqyrojnë kujtimet e të anketuarve, që i përkasin periudhës kur nëpër fshatra mungonte kujdesi i kualifikuar mjekësor dhe maternitetet (fillimi dhe mesi i shekullit XX). Kapitulli përfshin përshkrimin e përfytyrimeve dhe të praktikave gjatë dhe pas shtatzënisë (periudha dyzetditëshe, festat e lindjes), të lindjes tradicionale me ndihmën e *babos* dhe të riteve të shoqërizimit të fëmijës (pagëzimi, emërtimi dhe institucioni i kumbarisë). Disa paragrafë të veçantë u kushtohen përkufizimeve që lidhen me porsalindurin, hajmalive dhe teknikave të mbrojtjes (nga nimfat e ujit (*rusale*), nga syri i keq etj.), veçorive të kujdesit për foshnjën (mbështjellja me pelena, larja, shtrirja në djep, riti i kripësimit, ushqimi me gji). Me vëmendje të veçantë trajtohen subjektet që lidhen ngushtë me magji popullore dhe me mitologji, siç janë: përfytyrimet për demonët e fatit dhe braktisja rituale e fëmijës. Krahasimi me ritet e lindjes tek grupet e tjera etnike në këtë rajon (bullgarët, gagauzët, rusët dhe ukrainasit), si dhe tek popujt e Gadishullit Ballkanik (kryesisht shqiptarët) e lejon autoren të dallojë tipare të veçanta, të ruajtura si rezultat i kontakteve afatgjata ndëretnike, dhe tipare arkaike në kulturën e lindjes të shqiptarëve të Ukrainës. Analiza e të dhënave shoqërohet nga një shpjegim i leksikut, formulave të të folurit dhe shprehjeve që shënojnë aspekte të rëndësishme të riteve të lindjes.

Aleksandër A. Novik. A babos dita në traditën e shqiptarëve të rajonit të Detit Azov: atje ku kryqëzohen koordinatat hapësirore dhe kohore

Në kapitull analizohen materialet për festën *A babos dita* (shq. Azov.) që ishte e përhapur ndër shqiptarët e rajonit të Detit Azov deri në vitet 1970–1980 dhe

vazhdon të jetë e rëndësishme tek shqiptarët e Buxhakut deri në ditët tona. *A babos dita* është festa e mamive dhe lehonave, ajo ka lidhje të drejtpërdrejtë me të fshehtat e lindjes dhe të socializimit të mëtejshëm të vajzave dhe të grave në shoqëri. Kjo festë deri tani është shumë e njohur në Bullgari, ku ishte huazuar sipas analizës sonë nga mërgimtarët shqiptarë të shpërngulur nga rajonet juglindore të Shqipërisë së sotme. Sot po nguliten motivime dhe skenare të larmishme lidhur me kremtimin e kësaj feste ndër shqiptarët e Priazovjes të shekullit XX: nga nderimi i mamisë, që ndihmonte në lindjet e komunitetit femëror (fshati Devninskoje) deri në dorëzimin e dhuratave gruas më të moshuar të fshatit (Georgievka); në të dy rastet kemi të bëjmë me perceptimin e misterit të pjellorisë, me traditën e nderimit ritual të mundësisë së gruas për të lindur fëmijë. Rrëfimet e regjistruara nga autori ilustrjnë edhe një komponent tjetër të rëndësishëm të festës, një ritual gaztor, ku lejohen thuajse të gjitha gjërat e ndaluara, madje (dhe sidomos) ato që klasifikohen si tabu në jetën e përditshme, jofestive, si dhe argëtimi i shtirë, në të cilin shakatë, talljet, përfshirja e një numri të madh pjesëmarrësish janë kushti i domosdoshëm dhe çelësi i kryerjes së ceremonisë rituale të nderimit të mamisë / gruas më të moshuar të fshatit.

Aleksandër A. Novik. Dasma dhe traditat e martesës ndër shqiptarët e Ukrainës

Në kapitull analizohen institucioni shoqëror i martesës (zgjedhja e bashkëshortit / bashkëshortes, kushtet ekonomike dhe sociale të nënshkrimit të martesës, faktori rajonal, stereotipet etnike etj.) dhe ritet martesore tek shqiptarët e Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov në shekullin XIX — fillim të shekullit XXI. Dasma është një nga ngjarjet kryesore jo vetëm në jetën e njeriut, i cili ndryshon statusin e tij social në mënyrë të dukshme, por edhe në jetën e familjes së tij, të farefisit, shoqërisë vendase, nganjëherë madje edhe të komunitetit fisnor dhe krahinor. Autori në bazë të materialeve të vjela në terren gjatë ekspeditave rindërton kodin veprues të dasmës, duke sqaruar skenarin e ceremonive martesore në vitet 1940, të cilat konsiderohen nga të anketuarit kryesorë dhe me autoritet si tradicionale dhe shqiptare (sic!). Në këtë pjesë të monografisë analizohet leksiku i terminologjisë së riteve të dasmës (ky fjalor është shumë i pasur), vjelë nga autori, si dhe rrëfimet e regjistruara në të folmen vendase dhe në rusisht tek shqiptarët e lindur në vitet 1900–2000; ky fakt lejon të bëhen krahasime të gjendjeve kalimtare që ndodhin në fushën e gjuhës dhe të traditave. Ritet dhe zakonet martesore që janë ndikuar fort prej traditave të etnive të tjera (si pasojë e kontakteve intensive me fqinjë të afërt bullgarë, gagauzë, rusë dhe ukrainas, si dhe proceseve të globalizimit në dhjetëvjeçarët e fundit) dhe struktura e të cilave është transformuar ndjeshëm me risi në kushtet e zbehjes së vazhdueshme të traditës, nga pikëpamja e metodikës shpjegohen me shumë shembuj materialesh të grumbulluara në terren. Kapitulli

ilustrohet me shumë fotografi të Julia Vladimirovna Ivanovës, që janë bërë në rajonin e Detit Azov në vitin 1949 dhe ruhen në Arkivin e Institutit të Etnologjisë dhe të Antropologjisë (Moskë).

Denis S. Ermolin. Ritet mortore e përkujtimore dhe kultura e varrimit

Kjo pjesë e monografisë kolektive u është kushtuar përfytyrimeve, besimeve dhe praktikave lidhur me vdekjen e njeriut dhe me kulturën e varrezave tek shqiptarët e Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov. Materialet për ritet mortore dhe përkujtimore janë mbledhur nga autori gjatë kërkimeve shkencore në terren në fshatrat shqipfolëse në jug të Ukrainës (vitet 2007–2011). Në kapitull trajtohet një spektër i gjerë çështjesh kushtuar një tematike të përgjithshme: përfytyrimet e shqiptarëve të Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov për vdekjen dhe çka lidhet me të (fati dhe lajmësit e vdekjes, etapat e përgatitjes së varrimit dhe riteve të tjera, kompleksi përkujtimor dhe kultura e organizimit të hapësirës së varrezave). Disa paragrafë të veçantë i janë kushtuar rolit të priftit, veçorive të varrimit të fëmijëve të papagëzuar, beqarëve, vetëvrasësve. Në kapitull shpjegohen me hollësi kompleksi përkujtimor kalendarik dhe shndërrimet e tij gjatë shekullit XX. Është përshkruar kultura e varrezave e fshatrave shqiptare të Ukrainës me shembuj të veçantë të varrezave të Georgievkës (rajoni i Detit Azov) dhe ato të Karakurtit (Buxhak); këto materiale na lejojnë të hulumtojmë ndryshimin e tipeve të përmendoreve mbivarrore, të analizojmë parimet e organizimit të hapësirës së varrezave tek grupi etnolokal në studim. Në bazë të studimit të motiveve ballkanike në strukturën e riteve mortore të shqiptarëve të Ukrainës është arritur në përfundim se këto komponente të riteve në kohën e sotme luajnë një rol markues identiteti etnik dhe / ose rajonal. Elementet e ritit dhe përfytyrimet ballkanike që janë ruajtur në kulturën e shqiptarëve të Ukrainës kanë paralele me kompleksin mortor-përkujtimor të traditave të përbashkëta dhe rajonale të Gadishullit Ballkanik. Krahasimi i kompleksit mortor-përkujtimor të shqiptarëve të Ukrainës me traditat e përhapura në Ballkan, kryer nga autori, na tregon për hyrjen e kulturës së kolonëve të Buxhakut dhe të rajonit të Detit Azov në arealin kulturor karpato-ballkanik, si dhe për vijimësinë e ruajtjes së praktikave dhe përfytyrimeve tradicionale.

Vëllimi 2

Kreu III. MJEKËSIA POPULLORE

Aleksandër A. Novik, Julia V. Buçatskaja. Praktikat mjekësore popullore si resurs i sigurimit të jetës në fshatrat Georgievka, Devninskoje dhe Gammovka

Kapitulli u është kushtuar praktikave të ndryshme të shërimit të sëmundjeve me mjete ndihmëse në kushtet shtëpiake, si dhe analizës së rasteve të kërkimit të ndihmës nga mjekët popullore të përhapur në mjedisin fshatar të shqiptarëve të rajonit të Detit Azov, me shembuj dhe material krahasues nga mjekësia popullore bullgare. Për herë të parë janë grumbulluar materiale të shumta nga kërkimet në terren (me metodën e vëzhgimit të drejtpërdrejtë) dhe intervistat me mjekë popullorë, formulat e “lutjeve” të tyre. Ruajtja e praktikave të vetëshërimit dhe përhapja e përdorimit të ndihmës së mjekëve popullorë analizohen në kontekstin e konceptit teorik të burimeve të kufizuara, në rastin konkret, në kushtet e resurseve të kufizuara, siç janë ndihma mjekësore profesionale, pajisjet teknike të qendrave mjekësore në fshatra, mobiliteti dhe paratë (financat).

Kreu IV. VESHJET TRADICIONALE

Aleksandër A. Novik. Veshjet tradicionale të shqiptarëve të rajonit të Detit Azov dhe të Buxhakut

Në monografinë kolektive për herë të parë përshkruhen komplekse të ndryshme të veshjeve popullore të shqiptarëve të Ukrainës krahasuar me kostumin e bullgarëve të shpërngulur në Perandorinë Ruse në fillim të shekullit XIX dhe me atë të shqiptarëve të fshatit Mandricë të Bullgarisë (mërguar nga Shqipëria Juglindore në gjysmën e parë të shekullit XVII). Miti që ka ekzistuar më parë si në mjedisin popullor edhe nëpër botime e studiuesve të mëparshëm për mëtimin që shqiptarët dhe bullgarët të kenë pasur të njëjtat veshjet (fjala është kryesisht për rajonin e Detit Azov në fund të shekullit XIX — gjysmën e parë të shek. XX), për herë të parë kritikohet këtu me argumenta konkrete dhe bindëse në bazë të koleksioneve muzeale (në radhë të parë të Muzeut të Antropologjisë dhe Etnografisë të Sankt Peterburgut) dhe të artefakteve të ruajtura nëpër sënduqë banorësh të moshuar të fshatrave shqiptare dhe bullgare. Materialet për veshjet tradicionale të shqiptarëve të Ukrainës analizohen për herë të parë duke përfshirë të dhëna për kostumin e shqiptarëve të fshatit Mandricë të Bullgarisë, grumbulluar gjatë ekspeditës së vitit 2014. Materiale të tilla më parë nuk sqaroheshin nga

studiuesit për shkak të interesit të kufizuar nga kuadri shkencor (shqiptarët e Mandricës ishin kryesisht objektet e hulumtimeve të lingvistëve dhe historianëve) dhe të ruajtjes së dobët të veshjeve popullore tek dy këto grupe të etnosit shqiptar. Pjesa e A.A. Novikut ka shumë ilustrime të grumbulluara me një punë shumëvjeçare, gjatë së cilës ai ka hulumtuar në terren temën e kostumit shqiptar dhe prodhimin e tij.

Kreu V. GJUHA

Maria S. Morozova. E folmja e shqiptarëve të Ukrainës: përshkrim i shkurtër i gramatikës

Kapitulli i M.S. Morozovës kushtuar së folmes së shqiptarëve të Ukrainës përmban një përshkrim të shkurtër të gramatikës të së folmes në gjendjen e saj aktuale dhe bazohet në materialet e mbledhura nga autorja gjatë ekspeditave në fshatrat shqipfolëse të Buxhakut (2011–2013) dhe të rajonit të Detit Azov (2005–2010, 2012). Trajta të zgjedhura të morfologjisë emërore dhe foljore e të sintaksës të së folmes së shqiptarëve të Ukrainës interpretohen në këtë përshkrim si arkaike ose të reja në krahasim me të folmet e tjera të shqipes. Krahasimi me gjuhën letrare shqipe, me të folmet e zonës “nënë” të toskërishtes veriore dhe me të folmet toske në jug të Italisë, në Greqi dhe në Bullgari është kryer me përdorimin e përshkrimeve dialektologjike, të gramatikave të shqipes standarde dhe të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe (ADGjSh). Zhvillimi i risive morfologjike dhe sintaksore në të folmen në shqyrtim analizohet duke përdorur materialet arkivore dhe botimet e N.S. Derzhavit (materiali i mbledhur në terren në vitet 1920 në rajonin e Detit Azov), artikujt dhe materialet e S. Islamit (rajoni i Detit Azov, ekspedita e vitit 1949), N.V. Kotovës (Buxhak dhe rajoni i Detit Azov, 1950–1954) dhe të L.J. Demkos (Zhovtnevoje, vitet 1960), botimet e gjuhëtarëve nga Leninqradi / Sankt-Petërburgu të bazuara në rezultatet e ekspeditave të viteve 1960–1970 në Zhovtnevoje dhe në fshatrat shqiptare të rajonit të Detit Azov, si dhe duke përdorur punimet e reja në bazë të materialeve të ekspeditave të viteve 1998–2013. Përshkrimi i materialit shoqërohet me shembuj nga Karakurti / Zhovtnevoje dhe nga fshatrat e rajonit të Detit Azov. Shtojca e kapitullit përmban tabelat gramatikore me pasqyrimin e tipave kryesorë të lakimit e të zgjedhimit në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës (shih gjithashtu shtojcën e librit “Tekstet në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës”).

Aleksandër A. Novik. Në vend të konkluzioneve

Në konkluzione Aleksandër A. Novik duke përfunduar monografinë kolektive përmend temat kryesore që janë sqaruar në libër dhe përshkruan planet

e mëtejshme të grupit të autorëve në fushën e studimit të gjuhës dhe kulturës së shqiptarëve të Ukrainës, pasardhësve të “kolonëve përtej Danubit”. Këto tema të hulumtimeve të ardhshme janë: festat tradicionale, feja e krishterë dhe vendet e pelegrinazhit, stollitë e shqiptarëve të Ukrainës, ekonomia fshatare dhe zejet popullore, prodhimi i verës, blegtoria (delet), tekstili tradicional, gjendja socio-linguistike etj. Autorët gjithashtu kanë në plan të botojnë “Fjalorin e së folmes së shqiptarëve të Ukrainës”, ky botim është konceptuar në dy pjesë: shqip-rusisht dhe rusisht-shqip. Tematika e hulumtimeve dhe rajonet e studimeve shkencore në terren të “Ekspeditës në Azov” po zgjerohen kohët e fundit: kështu, në vitet 2015–2016 janë organizuar kërkime në terren në rajonet e Detit Azov (Priazovje) të Rusisë (rajoni i Rostovit), ku në fund të shekullit XVIII kanë qenë themeluar vendbanimet e arnautëve — shqiptarëve dhe grekëve, që kishin marrë toka si shpërblim për shërbimin në ushtrinë ruse. Grupit të shkencëtarëve me përvojë vitet e fundit i janë bashkuar studiues të rinj, në sferën e interesave të cilëve përfshihen çështje si nga fusha e gjuhësisë dhe etnologjisë (që kanë përparësi për autorët e kësaj monografie kolektive), ashtu edhe nga fusha e arkeologjisë, muzeologjisë, historisë të së drejtës, folkloristikës etj.

SHTOJCË

Maria S. Morozova. Tekste nga e folmja e shqiptarëve të Ukrainës

Aleksandër A. Novik. Tekstet dialektore

Në shtojcën e hartuar nga M.S. Morozova dhe A.A. Novik botohen tekstet dialektore. Në pjesën e parë janë përfshirë tekste dhe fragmente incizimesh nga e folmja e shqiptarëve të Ukrainës, të regjistruara gjatë ekspeditave në fshatin Zhovtnevoje / Karakurt (2011–2013) dhe Georgievka, Devninskoje dhe Gammovka (2005–2010, 2012). Tekstet dhe incizimet nga Zhovtnevoje, Georgievka dhe Devninskoje, si dhe një bisedë me A.D. Serbinën (lindur më 1938) nga fshati Gammovka janë regjistruar dhe transkriptuar prej M.S. Morozovës. Intervistën me Z.M. Kajraçkën (lindur më 1929) nga fshati Gammovka e regjistruan D.S. Ermolini dhe I.K. Uçiteli; fragmenti që botohet është transkriptuar prej M.S. Morozovës. Të gjitha tekstet paraqiten në transkriptim fonetiko-fonematik duke përdorur simbolet e Alfabetit Fonetik Ndërkombëtar (IPA). Subjektet kryesore të tregimeve të përfshira në këtë shtojcë janë: ritet e dasmës (kumbaria dhe funksionet e kumbarit e të ndrikullës në dasmë), *kurbáni* në fshatin Zhovtnevoje / Karakurt (therja e qengjit, gatimi i ushqimit, gostia), kuzhina tradicionale (*jagní, bábo, péte, brumërat*), mjekësia tradicionale (“frika”), të menduarit rreth jetës rurale dhe biografitë e të anketuarve. Gjithashtu, botohen tekstet e dy këngëve popullore, të cilat i ka kënduar E.I. Dzingova (lindur më 1922) nga fshati

Devninskoje. Në pjesën e dytë të shtojcës për herë të parë botohen tekstet e lutjes “Ati ynë” në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës, incizuar nga A.A. Noviku gjatë intervistës me N.G. Kirçevën (lindur më 1970) nga fshati Karakurt (biseda është regjistruar në Tiranë, Shqipëri, më 26.09.2015) dhe L.F. Danilenko (mbiemri sipas babait Burllaçko, lindur më 1966) nga fshati Georgievka (kërkime shkencore në terren, në fshatrat shqiptare të rajonit të Detit Azov në gusht të vitit 2006). Tekstet janë transkriptuar me alfabetin e shqipes standarde, duke përdorur disa shenja suplementare.

Monografia kolektive përfshin: burimet dhe bibliografinë (në fund të çdo kapitulli), listën e të anketuarve, listën e botimeve të grupit të autorëve për shqiptarët e Ukrainës, listën e disertacioneve dhe të referateve të disertacioneve të grupit të autorëve të mbrojtura për shqiptarët e Ukrainës, listën e mbështetjes financiare nga fondacionet shkencore të fituar nga autorët e monografisë kolektive për studimin e gjuhës dhe të kulturës së shqiptarëve të Ukrainës, treguesin gjeografik, treguesin e personave, treguesin tematik, shkurtime emërtimesh, përmbledhje të kapitujve të monografisë kolektive në rusisht, anglisht dhe shqip, informacionin për autorët në rusisht dhe anglisht, hartat.

*(Përkthyen në shqip Aleksandër Novik dhe Maria Morozova,
redaktimi gjuhësor i tekstit shqip u krye nga Aristotel Spiro)*